# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-479523**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Reagimi - ‘Balluku ka marrë peng Edi Ramën’, Bardhi: Vendos për punësimet, tenderat e koncesionet |
| ADRESA | `https://www.syri.net/politike/919960/balluku-ka-marre-peng-edi-ramen-bardhi-vendos-per-punesimet-tenderat-e-koncesionet/` |
| BURIMI | syri.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 29 shtator 2026, 14:18:35 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 29 shtator 2026, 13:47:06 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | 78b310b402e3eb6c66bf20de1c6fb2487d77a90fc817e2f7b5e7d92c3d775f79 |
| TEKSTI | 608457cd1a542ef3fe5e79d9fad719d709fdbc12d2b66f0f8afe25d3467b8c01 |
| PAMJA | 25ca5693c8a79b2b716faf0214c44e6c505da3690d0919e2cdcf63c597a7bb62 |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | 56a97bf86e0443d599472f7e73432c905ca91e41bafed671bfff947760d9c493 |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | 5df8b09a82e67beafe6b324836ab8231b0f747e1cb5c8d4c8cb1ac702cd5a645 |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/56a97bf86e0443d599472f7e73432c905ca91e41bafed671bfff947760d9c493`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



NIKOLA KEDHI
Kontrata e Dinjitetit: Ose e shpëtojmë bashkë Shqipërinë, ose e humbim përgjithmonë



GENC POLLO
Dy Edi Ramat në Nju Jork dhe raporti i sikletshëm me të tashmen e të shkuarën




# 'Balluku ka marrë peng Edi Ramën', Bardhi: Vendos për punësimet, tenderat e koncesionet

15:47, 29/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

+ Aa -

**Kreu i Grupit Parlamentar të PD, Gazment Bardhi shprehet se tashmë është fakt i ditur dhe i përsëritur se Belinda Balluku ka marrë peng kryeministrin Edi Rama.**

Teksa iu referua një investigimi të fundit të mediave për Ballukun, Bardhi përmes një statuski në rrjetet sociale, shkruan se ish zëvendësja e Ramës vijon të qeverisë de facto Ministrinë e Infrastrukturës dhe institucionet e saj të varësisë.

'Ajo vazhdon të vendosë kush punësohet, kush fiton tendera dhe kur jepen koncesione, shkruan Bardhi.

Sipas tij, është e papranueshme që Balluku të rendë e lirë, sa kohë ndaj saj rëndojnë 6 akuza penale, ndërsa i kërkoi SPAK të zbatojë ligjin.

'Sepse në një shtet ligjor, pushteti nuk duhet të jetë mburojë dhe askush nuk duhet të jetë mbi ligjin', përmbyll reagimin Gazment Bardhi.

**Reagimi:**

*Dje, një investigim i emisionit "Fiks Fare" nxori sheshit atë që të gjithë e dinin. Belinda Balluku, për shkak se ka marrë peng Edi Ramën, vazhdon të qeverisë de facto Ministrinë e Infrastrukturës dhe institucionet e saj të varësisë. Ajo vazhdon të vendosë kush punësohet, kush fiton tendera dhe kur jepen koncesione.*

*Shefja e Ramës dhe Karakaçit, Belinda Balluku, nuk duhet të ishte duke shkuar në palestër, por pas hekurave.*

*Për fat të keq, edhe pse SPAK-u ka 20 ditë që ka bërë publike të dhëna të reja për marrjen e saj nën hetim për korrupsion, pastrim parash dhe fshehje pasurie, ende nuk ka zbatuar ligjin për burgosjen e saj. Është e paimagjinueshme për një shtet ligjor që një person me 14 akuza penale të shëtisë lirshëm dhe madje të gjejë kohë edhe për palestër.*

më të lexuarat

'Asnjë hap pas'/ Dita e 120-të e protestave, pankartat: Edi, po të vjen fundi me ndëshkim!

'Rama padrino i Tahirit, Veliajt, Ballukut, Gysit, Vlorës'/ Bushati: Funskionimi i shtetit si bandë mafioze

VIDEO/ Balliu: A ka folur Edi Rama me Ergys Agasin përmes telefonit të Vlora Hysenit?

Epitafi i frikës, apo frika e epitafit?

Berisha: Vlora Hyseni është kthyer për t'u dhënë restin bashkëpunëtorëve të vet që e tradhtuan

Berisha: Foltoret e Ripërtëritjes në Vlorë dhe Elbasan dëshmuan se orteku i opozitës po rritet çdo ditë

*kohë edhe për palestër.*

*SPAK-u duhet të zbatojë ligjin. SPAK-u duhet të zbatojë standardin që vetë vendosi në dhjetor 2025. SPAK-u nuk mund t'u thotë shqiptarëve se, kur ndaj Belinda Ballukut rëndojnë 6 akuza, ajo duhet të shkojë në burg, ndërsa kur rëndojnë 14 akuza, duhet të shkojë në palestër. Kjo është thjesht e papranueshme!*

*Ligji duhet të jetë i njëjtë për të gjithë. Shqiptarët meritojnë një drejtësi që nuk njeh të paprekshëm. Opozita kërkon vetëm një gjë: zbatimin e ligjit, me të njëjtin standard për këdo, pa përjashtim. Sepse në një shtet ligjor, pushteti nuk duhet të jetë mburojë dhe askush nuk duhet të jetë mbi ligjin.*


VIDEO/ Shkullaku: Rama e nisi me krimin dhe po e mbyll me të, shqiptarët kanë të drejtë të reagojnë

Arrestimi i Vlora Hysenit/ Ish-ministri i Ramës: Vartësit imitojnë shefin e tyre, e sillen si ai

Fjalimi i turpshëm në OKB/ Berisha: Rama, armik i egër i Kosovës, tani po përhap shpifje të ulëta kundër VV-së


© SYRI.net


Lexo edhe:


SYRI TV/ Skandali i SHISH, Rama krenohet me sigurinë: Shqipëria, një nga vendet më të sigurta


Lamtumira e kërcënimeve e të pakallurit


Mashtruesi Rama dhe Reforma në Drejtësi!

TË NGJASHME

Spanja shembulli sesi protesta jep efekte

SYRI TV/ PS normalizon skandalin e SHISH dhe AKSHIT, Balla: Korrupsion ka dhe në Gjermani

Seanca për Kosovën/ Berisha në Strasburg: Drejtuesit e UÇK u dënuan me 84 vite, Apeli t'i shqyrtojë objektivisht!

Skandalet e qeverisë dhe zonat e mbrojtura/ Zhupa i ngre si shqetësime para delegacionit të Bundestagut

Rama nuk e fton në takimin me sportistë e trajnerë, reagon Godelli: Doni vetëm njerëz që ju thonë 'peqe pasha'?

Skandali në SHISH, PD kërkesë për informacion Kryeministrit dhe Presidentit: Si u emërua dhe dekretua Vlora Hyseni

Belinda, ftesa është e hapur, në çdo kohë

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHEGIMI MJEDIS ARKIVA


SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me


redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.